



Project Partners

With the support of:



Çfarë bëjmë ne:

IRC-HERMES adreson mbrojtjen, promovimin dhe zhvillimin e trashëgimisë kulturore. Projekti përqendrohet në parandalimin e rrezikut të shembjes së ndërtesave historike me anë të përdorimit të algoritmeve të menaxhimit dhe parandalimit. Një sistem dixhital i menaxhimit të trashëgimisë kulturore, si HERMeS, është testuar dhe njohur tashmë për inovacionin e tij në nivelin Evropian. Do të përditësohet dhe zgjerohet, pas hulumtimit, dokumentacionit dhe zbatimit, për katër qytetet pilot: Korfuzin, Samos, Ohrin dhe Gjirrokaster. Potenciali për ta zbatuar atë në rajone / vendbanime të tjera do të vlerësohet. Menaxhimi i trashëgimisë kulturore të rrezikuar është një nga objektivat e Programit INTERREG BALKAN-MED dhe posaçërisht të Prioritetit të Investimeve 6c "Ruajtja, mbrojtja, promovimi dhe zhvillimi i trashëgimisë natyrore dhe kulturore". Projekti IRC-HERMES është në kuadrin e Vitit Evropian të Trashëgimisë Kulturore 2018 dhe mbështetet nga Europa Nostra dhe HERMeS (OJQ).

www.irc-hermes.eu

FB: @IRC.HERMES



IRC-HERMES project is co-funded by the European Union and National Funds of the participating countries under the **INTERREG Balkan-Mediterranean 2014-2020** cooperation programme - Subsidy Contract No. BMP1/2.1/2321/2018

Interreg 
EUROPEAN UNION

Balkan-Mediterranean
IRC-HERMES

European Regional Development Fund




OUR HERITAGE:
WHERE THE PAST
MEETS THE FUTURE

2018 
EUROPEAN YEAR
OF CULTURAL
HERITAGE
#EuropeForCulture

InterRegional Cultural
HERitage Management E-
System

Objektivat:

- Zhvillimi i një sistemi të përbashkët inovativ dixhital për menaxhimin, mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore për vendet pjesëmarrëse, me zbatimin pilot për vendbanimet e Korfuzit, Samos, Gjirokastrë dhe Ohër.
- Përmirësimi i aftësive të secilit vendbanim për të promovuar dhe ripërdorur ndërtesat e tyre.
- Identifikimi dhe promovimi i trashëgimisë së përbashkët kulturore arkitektonike të Greqisë, Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë.
- Përgatitja e një plani të përbashkët në nivelin lokal dhe ndërkufitar - për turizmin tematik alternative në lidhje me mjedisin human (turizmi arkitektonik, turizmi për shkollat).
- Ndërgjegjësimi i qytetarëve për çështjet e mbrojtjes dhe restaurimit të trashëgimisë kulturore.
- Zhvillimi i mjeteve mësimore – edukuese për mësuesit dhe studentët me qëllim të forcimit të kurseve me temë trashëgiminë kulturore.



Rreth projektit:

Rezerva e pasur e aseteve kulturore në Korfuz, Gjirokastrë, Samos dhe Ohër është argumentuar se ka një potencial të madh në nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm, përmes krijimit dhe promovimit të një identiteti të veçantë kulturor të përbashkët. Në të gjitha këto zona ka vende të klasifikuara si Vende të Trashëgimisë Botërore Natyrore dhe / ose Kulturore, të cilat janë të lidhura me karakteristikat e tyre të përbashkëta historike, por edhe sfidat e zakonshme. Qëllimi i këtij projekti është zhvillimi i një platforme të përbashkët të menaxhimit strategjik për ndërtimin e vendbanimeve / rajoneve për të mbështetur shpëtimin, mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë së tyre kulturore. Për zhvillimin e platformës, objektet historike të ndërtesave dhe monumenteve do të vlerësohen dhe dixhitalizohen. Pas këtij procesi, një mjet i vendimmarrjes (algoritmi) do të përdoret për të dhënë përparësi në ndërhyrjet dhe do të prodhojë raporte të përbashkëta për autoritetet pjesëmarrëse.

Sistemi do të funksionojë në një platformë të unifikuar për të gjitha vendet duke iu referuar ndërtesave të tyre më të rëndësishme të trashëgimisë historike në mënyrë që të zhvillojë një lidhje midis këtyre ndërtesave dhe të gjejë tipare të përbashkëta të trashëgimisë së tyre kulturore, fizionomisë dhe tipologjisë. Të dhënat e sistemit do të jenë të hapura (pa të drejtat e autorit), të arritshme për publikun në dy gjuhë (Lokale dhe Angleze). Objektivat janë ofrimi i informacionit, mbështetja, transferimi i njohurive dhe sensibilizimi i qytetarëve. Ndërtesat historike do të pajisen me etiketime individuale në mënyrë që të informojnë vizitorët në lidhje me projektin dhe ndërtesën. Do të zhvillohet një udhëzues i specializuar për turne dixhital për ndërtesat historike, në mënyrë që vizitorët të mësojnë për trashëgiminë arkitektonike dhe të informohen për tiparet e përbashkëta të të gjitha ndërtesave historike. Më në fund, do të zhvillohet një portal arsimor online që mbështet mësuesit e të gjitha rajoneve për të përdorur mjete të trashëgimisë dixhitale në klasë.